



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
KOMISIONI MBARËVAJTJES SË VEPRIMTARISË DHE MARRËDHËNIEVE ME
STUDENTËT

**RREGULLORE E
KOMISIONIT TË MBARËVAJTJES SË VEPRIMTARISË DHE MARRËDHËNIEVE
ME STUDENTËT**

Baza ligjore e rregullores

Rregullorja e Komisionit të “Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me studentët” të Universitetit të Tiranës mbështetet në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 «Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë», në Statutin e Universitetit të Tiranës, miratur me Urdhërin nr. 816, datë 26.12.2018 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, në Vendimin nr. 41, datë 24.01.2018 “Për Elementet e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” Udhëzimin nr. 31, datë 29.12.2017 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë Për “Përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, në Udhëzimin nr. 29, datë 10.09.2018 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë për “Veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”.

Neni 1

Objekti

Komisioni i “Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me studentët” është një strukturë e ngritur pranë Universitetit të Tiranës që shërben për të siguruar një nivel cilësor të mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe të bashkëpunimit të ngushtë me studentët, pedagogët tutorë përkatës si dhe njësitë e brendshme të ngritura në këtë institucion. Kjo njësi funksionon në përputhje me ligjet në fuqi, statutin e institucionit, rregulloren e përgjithshme dhe shtesave të saj të aprovuara në Senatin e Universitetit të Tiranës.

Neni 2

Përbërja

Anëtarët e këtij Komisioni janë 7 (shtatë), të cilët vetëproponohen: 4 pedagogë dhe 3 studentë. Ata kanë një mandat 2 vjeçar dhe zgjidhen nga senati jo më vonë se një javë pas përfundimit të mandateve paraardhëse. Mandati bëhet i pavlefshëm kur:

1. Për Anëtarët Pedagog:

- 1.1. Jep dorëheqjen.
- 1.2. Largohet nga puna.
- 1.3. Ka mospërputhje me detyrat e tjera që mund të marrë.

2. Për Anëtarët Student:

- 2.1. Jep Dorëheqjen.
- 2.2. Përfundon statuti i tij si student.

Neni 3

Misioni

Misioni i këtij komisioni të përhershëm është të ndihmojë dhe bashkërendojë punën e stafit pedagogjik, administrativ dhe studentëve si dhe të monitorojë zbatimin e procedurave të aprovuara nga organet drejtuese për gjithë procesin mesimor në aspektin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

(Handwritten signatures)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
KOMISIONI MBARËVAJTJES SË VEPRIMTARISË DHE MARRËDHËNIEVE ME
STUDENTËT

Ai raporton për nivelin cilësor të realizimit të tyre dhe informon Dekanatet dhe Rektoratin me problematikat e hasura, arritjet, të metat, si dhe propozimet për rrugët dhe mjetet për përmirësimin e tyre. Çdo vit akademik ky komision brenda muajit janar i paraqet një raport me shkrim senatit.

Neni 4

Detyrat

Detyrat kryesore të këtij komisioni janë:

- a) Harton politikat për trajtimin e studentëve;
- b) Bashkëpunon me Këshillat Studentorë, Këshillin e karrierës, pedagogët tutorë dhe Alumni;
- c) Propozon mbështetjen financiare dhe logjistike të projekteve të studentëve;
- d) Kërkon informacione të ndryshme nga njësitë kryesore për probleme të studentëve;
- e) Kërkon informacion nga organet përbërëse të institucionit për çështje dhe probleme të paraqitura nga studentët dhe organizmat e tyre.
- e) Të orientojë studentët që në bashkëpunim me organet drejtuese të marrin pjesë në aktivitete sociale, kulturore, akademike, sportive etj.
- f) Bashkërendon punën dhe bashkëpunon me Komisionet e tjera të përhershme të ngritura nga Universiteti i Tiranës.
- g) Lehtëson komunikimin mes studentëve dhe stafit administrativ e akademik të Universitetit të Tiranës.

Neni 5

Instrumentat

Komisioni, për mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij, përdor metoda e mëposhtme:

1. Anketime të studentëve që ndjekin programet e studimeve dhe të Alumni;
2. Anketime të vlerësimit të didaktikës, të kurrikulës, të mësuarit;
3. Pyetje konceptuale;
4. Intervista;
5. Diskutime në Grup;

Neni 6

Përpunimi i anketimeve

Të gjitha anketimet përpunohen sipas një modeli të miratuar nga komisioni. Përpunimi i anketimeve dhe vlerësimi i pedagogëve, shoqërohet me një raport të hollësishtëm. Të gjitha materialet e anketimeve i vihen në dispozicion Senatit. Këto rezultate shpallen dhe ju vihen në dispozicion Fakulteteve dhe Departamenteve. Zyra e burimeve njerëzore e Rektoratit ruan raportet e anketimeve.

Neni 7

Bashkëpunimet

Komisioni i "Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me studentët" mund të krijojë dhe inkurajojë bashkëpunime me institucione të tjera universitare dhe jo, për të dhënë dhe për të shkëmbyer eksperiencë nga më të mirat dhe për të mbështetur iniciativë bashkëpunimi në fushën e arsimit.

Sasa Memeti
2019

Zylyftar

Bregu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
KOMISIONI MBARËVAJTJES SË VEPRIMTARISË DHE MARRËDHËNIEVE ME
STUDENTËT

Neni 8

Marrëdhëniet me Këshillat Studentorë

Komisioni i "Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me studentët" mban kontakte të rregullta me Këshillat Studentorë duke u informuar për problematikat dhe kërkesat e Studentëve.

Neni 9

Mënyra e Funkcionimit

1. Komisioni i "Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me studentët" zhvillon mbledhje periodike të paktën 1 herë në muaj.
 - 1.1. Kryetari vendos për datën dhe orën e mbledhjeve të radhës, përveç rasteve kur vetë Komisioni ka vendosur ndryshe.
 - 1.2. Çdo ndryshim në rendin e ditës, datën dhe orën e vendosur për mbledhjet i njoftohet të paktën 48 orë përpara datës së mbledhjes çdo anëtar i Komisionit, në mënyrë që ata të njihen me këto ndryshime.
 - 1.3. Lajmërimet për thirrjen e mbledhjeve bëhen nëpërmjet postës elektronike, të paktën 5 ditë përpara datës së thirrjes së mbledhjes, si edhe njoftimeve nëpërmjet telefonit.
 - 1.4. Kërkesa për të futur një çështje në rendin e ditës duhet të bëhet nëpërmjet postës elektronike, të paktën 72 orë para datës së vendosur për mbledhjen.
 - 1.5. Rendi i ditës, së bashku me dokumentacionin shoqërues duhet t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve, nëpërmjet postës elektronike, të paktën 48 orë përpara datës dhe kohës së mbledhjes.
2. Mbledhjet jashtë rradhe mund të organizohen me kërkesë me shkrim të të paktën 3 nga anëtarët e Komisionit.
3. Vendimet e Komisionit janë të Vlefshme kur janë të votuara nga 50% +1 të anëtarëve.
4. Raporti quhet i miratuar kur është votuar me shumicë të cilësuar.
5. Komunikimi me anëtarët e Komisionit dhe me institucionet e tjera bëhet me shkrim ose me anë të e-mailit.
6. Komisioni zgjedh mes anëtarëve një Sekretar që është përgjegjës për mbajtjen e procesverbalit të mbledhjeve.
7. Procesverbali i mbledhjes mbahet nga sekretaria e Komisionit dhe firmoset nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje.
8. Sekretaria ruan Bllokun e Procesverbaleve si dhe dokumentat e tjera.

KRYETARI
ALBAN FOCI

Arben Durrës
201

Kalvin Demush

[Signature]

Klodjan Skandery

Zylf-tar Bregu

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]

Klodian Karina